



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 660/ 7 prot

Datë 24.04.2023

V E N D I M
Nr. 292/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.04.2023 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-57534-01-31-2023, me objekt: “*Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit*”, me fond limit 5.975.666,67 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA.

Lënien të skualifikuar të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë “RIKON-AL” SHPK dhe “BNT ELECTRONICS” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit

Ankimues: Operatori ekonomik “PC STORE” SHPK.
Adresa: Rr. “Dibrës”, Vila 153, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA.
Adresa: Lagjja 17, Rr “Dalip Neza”, Durrës.

Subjekte të Interesuar: “InfoSoft Office” SHPK
Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 8, Kashar, Tiranë.

“RIKON-AL” SHPK
Adresa: Njësia Administrative Kashar, Rr: “Ismail Qemali” ND.40, H. 28, 1050, Yzberisht. Tiranë.

“BNT ELECTRONICS” SHPK

Adresa: Bulevardi “Zhan D'ark”, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 01.02.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-57534-01-31-2023, me objekt: “Shërbimi i

printimit dhe fotokopjimit”, me fond limit 5.975.666,67 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës, SHA.

II.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se në datën 17.03.2023, ka përfunduar procesi i vlerësimit të ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi me rezultatet si më poshtë:

1. RIKON-AL ShPK	oferta	4.315.000	Lekë pa TVSh	skualifikuar
2. InfoSoft Office ShPK	“	4.715.000	“	kualifikuar
3. PC STORE ShPK	“	4.930.000	“	kualifikuar
4. BNT ELECTRONICS ShPK	“	5.965.000	“	skualifikuar

II.3. Nga verifikimet e kryera, konstatohet, se më datë 23/03/2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin paraprak e fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike operatori ekonomik “PC STORE” SHPK ka paraqitur ankesë me numër ankimi elektronik A/2023/2988 datë 29.03.2023, protokolluar me Nr. 660/2023, datë 30.03.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertë së paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, si edhe pretendime që operatorët ekonomikë “RIKON-AL” SHPK dhe “BNT ELECTRONICS” SHPK të qëndrojnë të skualifikuar.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 660/2 Prot., datë 31.03.2023 në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesë nga operatori ekonomik ankimues .

II.6. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar shkresa me Nr. 324/40 prot., datë 31.03.2023, protokolluar me tonën me nr. 660/3, datë 03.04.2023, me objekt: “Informacion” nga Autoriteti Kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK. Autoriteti kontraktor me Vendimin e KSHA-së ka vendosur mospranimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK.

II.7. Në përputhje me nenin 113 ligji Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” më datë 03.04.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar shkresa protokolluar me tonën me nr. 660/4, datë 03.04.2023, me objekt: “Formulari i Paraqitjes së Argumenteve nga OE i interesuar “InfoSoft Office” SHPK” në lidhje me ankesën e paraqitur nga ankimuesi “PC STORE” SHPK.

II.8. Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik, me shkresën Nr. 660/5 prot., datë 05.04.2023, drejtuar autoritetit kontraktor, ka kërkuar dorëzimin pranë Komisionit të Prokurimit Publik të dokumentacionit paraqitur pranë AK-së nga operatori ekonomik fitues “InfoSoft Office” SHPK në përmbushje të kriterëve për kualifikim për të cilat ankimesi ngre pretendime.

II.9. Me shkresën me nr. 324/42 Prot., datë 07.04.2023, protokolluar me tonën me nr. 660/6 Prot., datë 11.04.2023, me objekt: “Informacion” nga autoritetit kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA, ka përcjellë në formë shkresore dokumentacionin provues të operatorit fitues “InfoSoft Office” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të dosjes si edhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, për mospërmbushje nga “InfoSoft Office” SHPK të kriterëve si më poshtë vijon:

1-Pikën 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik

Të paktën 2 (dy) specialistë/teknikë me diploma Inxhinierie/IT nga institucione arsimore vendase apo të huaja.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- *Kontratat e punës*
- *Diplomat*
- *Listëpagesat për 3 muajt e fundit nga data e publikimit të procedurës përkatësisht Tetor, Nëntor, Dhjetor.*

(Shënim-argumentoni nevojën për stafin e kërkuar, duke specifikuar shërbimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale, argumentimin mbi kërkesat dokumentare për disponimin e këtij stafi, si dhe nëse është rasti, për llojin e licencës/certifikatës/kualifikimit të kërkuar për secilin prej tyre, duke specifikuar edhe aktin ligjor apo nënligjor konkret, ku parashikohet nevoja për licencimin apo certifikimin e tyre).

2-KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9, në seksionin B: DEKLARATË Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen).

3- Pikën 2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose broshurë për mallin, letrën dhe softwar-in që oferton. Katalogu ose broshura duhet të jenë të përkthyer, noterizuara si dhe të markuara për verifikimin e specifikimeve teknike të pajisjeve si më poshtë:

- 10 Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A3 me shpejtësi printimi ≤ 45
- 6 Fotokopje/Printer/Skaner A3 Bardh e zi me shpejtësi printimi ≤ 55
- 5 Fotokopje/Printer/Skaner(Bardh/Zi) A4 me shpejtësi printimi ≤ 55
- Software për leximin, menaxhimin, raportimin sipas userave apo departamenteve, në lidhje me faqet e printuara, fotokopjuara,

Për Letër A4+A3 79.5-80.5 g/m², operatori ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/skedën teknike, në të cilën të gjejnë pasqyrim specifikimet teknike të kërkuara me produktet e ofruara. Katalogu/ skeda teknike duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe te noterizuara.

OE duhet të deklarojë adresat, nr. tel, email, emër mbiemër të personave të kontaktit në kompaninë prodhuese apo distributore, për verifikimin e të dhënave.

Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK duhet të skualifikohet.

III.1.1 Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK në përmbushje të kriterëve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontrate pune, diplome bachelor, diplome cikli i dyte i studimeve per Ing. B.Q, te noterizuara.
2. Kontrate pune, diplome bachelor, per Ing. M.K, te noterizuara.
3. Kontrate pune, diplome bachelor, Vertetim diplome cikli i dyte i studimeve si edhe certificate trajnimi per Ing. F.B, te noterizuara.
4. Listepagesat_2022_Tetor ku rezultojne tre ing. te punesuar.
5. Listepagesat_2022_Nentor ku rezultojne tre ing. te punesuar.
6. Listepagesat_2022_Dhjetor ku rezultojne tre ing. te punesuar.
7. Shtojca_8_Formulari_Permbledhes_i_Vetedeklarimit.
8. Katalog_Lexmark_MX511dhe_&_CX510de_&_MX711de_&_MX911_de (perkthyer dhe noterizuar).
9. Katalog_Ricoh_MP_C4503 (perkthyer dhe noterizuar)
10. Katalog_softëare_Papercut (perkthyer dhe noterizuar).
11. Deklarate_per_te_dhenat_e_kompanise_prodhuese_per_artikullin_leter.
12. Navigator_IO_marreveshje_distribucioni (perkthyer dhe noterizuar).
13. Navigator_skeda_teknike_prill_2019_e_re_me_firme_vule (perkthyer dhe noterizuar).

III.1.2. Referuar shkresës me nr. 324/42 Prot., datë 07.04.2023, protokolluar me tonën me nr. 660/6 Prot., datë 11.04.2023, me objekt: “Informacion” nga autoritetit kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës SHA ka përcjellë në formë shkresore dokumentacionin provues të operatorit ekonomik fitues “InfoSoft Office” SHPK, si vijon:

1. Shtojca_8_Formulari_Permbledhes_i_Vetedeklarimit.
2. Kontrate pune, diplome bachelor, diplome cikli i dyte i studimeve per Ing. B.Q, te noterizuara.

3. Kontrate pune, diplome bachelor, per Ing. M.K, te noterizuara.
4. Kontrate pune, diplome bachelor, Vertetim diplome cikli i dyte i studimeve si edhe certificate trajnimi per Ing. F.B, te noterizuara.
5. Listepagesat_2022_Tetor ku rezultojne tre ing. te punesuar.
6. Listepagesat_2022_Nentor ku rezultojne tre ing. te punesuar.
7. Listepagesat_2022_Dhjetor ku rezultojne tre ing. te punesuar.
8. Katalog_Lexmark_MX511dhe_&_CX510de_&_MX711de_&_MX911_de (perkthyer dhe noterizuar).
9. Katalog_Ricoh_MP_C4503 (perkthyer dhe noterizuar)
10. Katalog_software_Papercut (perkthyer dhe noterizuar).
11. Deklarate_per_te_dhenat_e_kompanise_prodhuese_per_artikullin_leter.
12. Navigator_IO_marreveshje_distribucioni (perkthyer dhe noterizuar).
13. Navigator_skeda_teknike_prill_2019_e_re_me_firme_vule (perkthyer dhe noterizuar).

III.1.3. Në nenin 39 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.
Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.
2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet.
Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.
Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen.
3. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.

III.1.4. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:
 - a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. **Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.**

Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për

III.1.6. Në nenin 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.7. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

- c) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve I të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;
- g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
- h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
- i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
- j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
- k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.
4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.
5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.
6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.9. Sa më sipër nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, për procedurën objekt-ankimi, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar: **-Pikën 2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:**

Të paktën 1 (nje) Inxhinier Elektronik

Të paktën 2 (dy) specialistë/teknikë me diploma Inxhinierie/IT nga institucione arsimore vendase apo te huaja. Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës
- Diplomat
- Listëpagesat për 3 muajt e fundit nga data e publikimit të procedurës përkatësisht Tetor, Nëntor, Dhjetor.

Pikën 2.4.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose broshurë për mallin, letrën dhe softwarin që oferton. Katalogu ose broshura duhet të jenë të përkthyer, noterizuara si dhe të markuara për verifikimin e specifikimeve teknike të pajisjeve si më poshtë:

- 10 Fotokopje/Printer/Skaner(me ngjyra) A3 me shpejtësi printimi ≤ 45
- 6 Fotokopje/Printer/Skaner A3 Bardh e zi me shpejtësi printimi ≤ 55
- 5 Fotokopje/Printer/Skaner(Bardh/Zi) A4 me shpejtësi printimi ≤ 55
- Software për leximin, menaxhimin, raportimin sipas userave apo departamenteve, në lidhje me faqet e printuara, fotokopjuara,

Për Letër A4+A3 79.5-80.5 g/m², operatori ofertues duhet të paraqesë katalogun e prodhuesit/skedën teknike, në të cilën të gjejnë pasqyrim specifikimet teknike të kërkuara me produktet e ofruara. Katalogu/ skeda teknike duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe te noterizuara.

OE duhet të deklarojë adresat, nr. tel, email, emër mbiemër të personave të kontaktit në kompaninë prodhuese apo distributore, për verifikimin e të dhënave.

Komisioni i Prokurimit Publik nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike konstaton, se operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në përmbushje të kriterëve të kualifikimit sipër cituar rezulton, se operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Office” SHPK ka dorëzuar dokumentacionin e ofertës (listuar në pikën III.1.1) si pjesë e ofertës paraqitur në SPE). Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. Autoriteti kontraktor i kërkon **ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285**, si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit në këtë fazë, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. Akoma më tej referuar informacionit të autoritetit kontraktor (cituar në pika III.1.2) operatori ekonomik fitues ka paraqitur dokumentacionin provues në formë shkresore pranë AK-së në përmbushje të detyrimit që ka operatori ekonomik fitues në një procedurë prokurimi.

Pra, në rastin konkret, operatori fitues “InfoSoft Office” SHPK ka përmbushur detyrimet jo vetëm me dorëzimin e Formularit të Vetëdeklarimit, por njëkohësisht të gjitha dokumentet në përmbushje të kriterëve për kualifikim, pjesë e ofertës në SPE në ditën e hapjes së procedurës së prokurimit, gjithashtu edhe dokumentacionin provues parashikuar në legjislacionin e prokurimit publik. Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik fitues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK në këtë procedurë prokurimi, është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK që operatorët ekonomikë “RIKON-AL” SHPK dhe “BNT ELECTRONICS” SHPK të qëndrojnë të skualifikuar edhe për arsye të tjera, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se këto pretendime nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik fitues “InfoSoft Office” SHPK nuk do të ndryshojë. Për më tepër nuk rezulton që këta operatorë ekonomikë të jenë ankuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi dhe renditja e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë do të vijojë të mbetet e njëjtë, rrjedhimisht ankimuesi nuk ka më interes të ligjshëm në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “PC STORE ” SHPK nuk do të merret në shqyrtim.

Në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-57534-01-31-2023, me objekt: “Shërbimi i printimit dhe fotokopjimit”, me fond limit 5.975.666,67 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Durrës SHA.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri